Kronikë

Sarandë/ Tentuan të vrisnin me eksploziv një 57-vjeçar, shpallen në kërkim dy autorët (EMRAT)

Policia ka identifikuar 2 autorët që tentuan të vrisnin me eksploziv Mirash Gjikolën në shkurt të këtij viti.

Mirash Gjikola dhe Xhafer Bajo

Redaksia
10 Maj, 12:15 | **Përditesimi: 10 Maj, 14:46**

Share Post

Policia e Sarandës ka zbardhur ngjarjen e 5 shkurtit të këtij vitit, kur në automjetin e Mirash Gjikola në Konispol u konstatua se ishte vendosur një sasi prej 6 kallëp tritol.

Fatmirësisht *lënda eksplozive* nuk shpërtheu, teksa nuk kishte funksionuar lidhja mes kapsollit dhe lëndës eksplozive, montuar në sediljen e pasme të automjetit të Gjikolës.

Policia bënë të ditur se ka shpallur në kërkim Griseld Taullaj persona ku u ble numri i telefonit përmes të cilit do të realizohej shpërthimi i telekomanduar dhe Xhafer Bajo, i dyshuar si autori kryesor i kësaj ngjarje.

Mirash Gjikolaj i cili shpëtoi mrekullisht pas këtij atentati ka depozituar në Polici dyshimet e tij, teksa ngjarjen e lidh dhe me një plagosje të realizuar nga ai në Lezhë shumë vite më parë. Ka qenë pikërisht kjo ngjarje për të cilën ai thotë se ka vendosur dhe të zhvendoset në drejtim të Konsipolit, ndërkohë që ka kryer dhe dënimin për plagosjen në fjalë.

Sipas policisë, Griseld Taullaj dhe Xhafer Bajo pritet të gjykohen për vrasje me paramendim dhe mbajtje të armëve dhe municioneve luftarake.

39 vjeçari Bajo dyshohet se hyri në oborrin e banesës së Mirash Gjikolaj ku dhe ka montuar lëndën eksplozive. Një javë para ngjarjes se 5 shkurtit, Gjikola nga Lezha me banim në Konispol kishte konstatuar dhe helmimin e qenit në oborrin e banesës së tij.

Për zbulimin e kësaj ngjarje duket se kanë ndihmuar dhe kamerat e sigurisë në banesën e Gjikolës.

Njoftimi i plotë:

Si rezultat i një pune intensive hetimore nga strukturat për Hetimin e Krimeve të Rënda në DVP Vlorë dhe Komisariatin e Policisë Sarandë, nën drejtimin e Prokurorisë pranë Gjykatës së Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë, për zbardhjen e ngjarjes së ndodhur më datë 05.02.2026, në vendin e quajtur "Kryqëzimi i Urës së Vrinës", në Konispol, pas provave të grumbulluara dhe informacionevë të siguruara, u bë identifikimi dhe shpallja në kërkim e autorëve të dyshuar të kësaj ngjarjeje, konkretisht shtetasve:

G. T., 39 vjeç dhe Xh. B., 39 vjeç, të dy banues në Sarandë.

Për këta shtetas, Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë ka caktuar masën e sigurisë "Arrest në burg", për veprat penale "Vrasja me paramendim", kryer në bashkëpunim, mbetur në tentativë", si dhe "Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyese dhe municionit".

Nga hetimet dyshohet se këta shtetas kanë vendosur një sasi lënde plasëse në automjetin që drejtohej nga shtetasi M. Gj., 57 vjeç, me qëllim vrasjen e tij.

Strukturat e Policisë vijojnë punën intensive për lokalizimin, kapjen dhe vënien e tyre përpara përgjegjësisë ligjore.

Ndërkohë, në bashkëpunim me Prokurorinë, vijon puna për dokumentimin e plotë ligjor, identifikimin dhe kapjen e personave të tjerë të përfshirë në këtë ngjarje.

Sqarim: Çdo person prezumohet i pafajshëm deri sa nuk vërtetohet fajësia e tij me vendim gjyqësor të formës së prerë

Xh.K/Shqiptarja.com

TAG: Xhafer Bajo | Griseld Taullaj | #mirash gjikola | Vlorë | sarandë

Komento

Komente

Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

Sondazhi i ditës:
9 Maj, 13:00
PS propozon masa më të ashpra për shoferët e dehur e ata të rinj, si iu duket?

E drejtë | E gabuar | Nuk e di

Lajme të tjera

Sezoni i ri turistik, rëndohet trafiku në lungomaren e Vlorës (VIDEO)
10 Maj, 23:00

Lehtësohet dhe përshpejtohet lëvizja e udhëtarëve, dogana greke zgjat orarin për pikën kufitare të Qafë Botës
10 Maj, 22:31

Nga Noizy te Elgit Doda, yjet e muzikës çelin sezonin turistik në Vlorë me një koncert plot gjallëri (VIDEO)
10 Maj, 22:11

Muzeu Pavarësisë në Vlorë, Ina Zhupa: Krisje muresh dhe rrezik shembjeje, degradim për dinjitetin kombëtar! Duhet ndërhyrje e menjëhershme
10 Maj, 10:36

Çelja e sezonit turistik në Vlorë, koncert spektakolar në 'zemër' të Lungomares! Mijëra qytetarë në shesh (VIDEO)
9 Maj, 21:40

Kontrolle 'blic' në burgjet e Fierit, Vlorës dhe Peqinit, sekuestrohen mjete prerëse të improvizuara dhe aksesorë celularësh
9 Maj, 18:14

Auron Tare: Të duash ndershmërisht kulturën hebraike
Auron Tare
9 Maj, 16:28

Historia e pazakontë e vlonjatit që zhytet 15 metra, pa bombol oksigjeni, për të kapur peshq në thellësi
Armand Xhelili
9 Maj, 14:53

Vlora çel sezonin turistik me koncert, sport, panaire dhe teatër, kryebashkiakja Mersini: Numri i vizitorëve, më i lartë se në 2025-ën
Armand Xhelili
9 Maj, 13:54

Vrasja e biznesmenit në Sarandë/ Zbardhet dëshmia e të plagosurit: Konfliktin e kisha me mikun e tij për një lokal në Himarë
9 Maj, 10:58

Mjegulla 'pushton' aksin rrugor Kardhiq-Delvinë, 5 aksidente! Shkak, mungesa e shikueshmërisë (VIDEO)
8 Maj, 21:43

Zjarr në një lokal në Radhimë të Vlorës, flakët përhapen edhe në kodrën aty pranë! Dyshohet për zjarrvënie të qëllimshme (VIDEO)
8 Maj, 21:31

© 2011 - 2026 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje